

MJEDISI SOT

*Qytetarët mendojnë
se duhet t'i hedhin mbetjet "tutje"!*

*Autoritetet mendojnë
se duhet t'i hedhin mbetjet "tutje"!*

**Kur flitet për të hedhur...
nuk ekziston një "tutje"!**



Ri-imagjino MBETJET!
energji•kohë•para



MJEDISI SOT

është një botim periodik i Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) Zyra në Shqipëri. Në këtë botim periodik do të gjeni informacion për probleme mjedisore, lajme të përzgjedhura, opinione e komente për çështje të mjedisit nga vendi dhe rajoni, informacione për aktivitete për mjedisin nga vendi dhe bota etj. Versionin elektronik të kësaj reviste mund ta gjeni në faqet: <http://albania.rec.org> dhe www.mjedisitot.info

Për të marrë "Mjedisi Sot", e përditshme elektronike, me postë elektronike apo revistën "MJEDISI SOT" (botim periodik), dërgoni emrin dhe adresën tuaj pranë REC Shqipëri, në: info.albania@rec.org • www.mjedisitot.info, ose telefononi në Tel/Faks: (04) 2 23 29 28.



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT Shqipëri

është një organizatë ndërkombëtare jopartizane, joavokate, jofitimprurëse me mision mbështetjen për zgjidhjen e problemeve mjedisore në Europën Qendrore e Lindore (EQL). Qendra e përmbush misionin e saj duke nxitur bashkëpunimin ndërmjet organizatave joqeveritare, qeverive, bizneseve dhe aktorëve të tjerë mjedisorë, si dhe duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore.

REC është krijuar në 1990 nga Shtetet e Bashkuara, Komisioni Europian dhe Hungaria. Sot REC bazohet ligjërisht në Kartën e REC, nënshkruar nga 29 vende dhe Komisioni Europian dhe në një marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë hungareze. REC ka zyrën qendrore në Szentendre, Hungari dhe zyrat e vendeve në secilin prej 17 vendeve përfituese, të cilat janë: Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Republika Çeke, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, RIJ e Maqedonisë, Polonia, Rumania, Serbia, Mali i Zi, Sllovakia, Sllovenia dhe Turqia.

Donatorët më të fundit janë Komisioni Evropian dhe qeveritë e Shqipërisë, Austrisë, Belgjikës, Bosnje-Hercegovinës, Kanadasë, Kroacisë, Republikës Çeke, Danimarkës, Estonisë, Finlandës, Gjermanisë, Hungarisë, Italisë, Japonisë, Letonisë, Lituanisë, RIJ të Maqedonisë, Hollandës, Norvegjisë, Polonisë, Serbi-Malit të Zi, Sllovenisë, Suedisë, Zvicrës, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, si dhe organizata të tjera ndërqeveritare dhe institucione private.

NË KËTË NUMËR

EDITORIAL 3

Rrethi vicioz: unë, pushteti vendor dhe mbetjet

NGA VENDI 4

Raporti i progresit 2012: Reflektim mbi progresin e Shqipërisë në fushën e mjedisit

AKTUALITET 5-6

Të shpëtojmë atë pak që na ka mbetur!

Lëvizjet qytetare dhe mbrojtja e mjedisit në Shqipëri

AKTIVITETE REC 7

Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e programit SENiOR-A

TEMA E NUMRIT 8-16

Bashkëpunimi në menaxhimin e mbetjeve, një domosdoshmëri për njësitë vendore

Problematika e mbetjeve urbane

Menaxhimi Lokal dhe Rajonal i Mbetjeve në Shqipëri

"Landfilli" rajonal i Bushatit

Politikë-bërja me pjesëmarrje për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri

Zadrimë, të dua të pastër!

PROFIL PROJEKTI 17

Një rrjet i Planifikimit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor

NGA BOTA 18-19

"Nga rubineti" - Film dokumentar kundër prodhimit dhe konsumit në masë të ujit të ambalazhuar në shishe

Kanë kontribuar për këtë numër:

Themi Perri • Ardian Hackaj
Bendis Bocari • Eduart Cani
Kadri Gega • Arben Kopliku
Zija Gerbeti • Sherif Lushaj
Zef Vokri • Nathan Johnson

Stafi Editorial

Mihallaq Qirjo • Eduart Cani
Jula Selmani • Genta Hoxha
Daniela Ruçi • Rezart Kapedani

Mbështetur nga:



në kuadër të
programit



Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri

Opinionet e shprehura në shkrimet e kësaj reviste nuk paraqesin domosdoshmërisht opinionet e Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC) apo të Qeverisë Suedeze

Rrethi vicioz: unë, pushteti vendor dhe mbetjet

Mihallaq Qirjo
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

Moria e diskutimeve dhe e debateve për mbetjet, në gjithë dimensionet e saj, ma vështirëson mendimin aq shumë, sa që shpesh nuk di nga ta filloj. Dilemën time përpiqem ta zgjidh duke shikuar, së pari, brenda familjes, atje ku prodhohen mbetjet. Por, nuk e zgjidh dot, se kufizohem nga infrastruktura e munguar dhe ndjenja vetmitare e “don Kishotit” për të bërë diçka më shumë. Sa prej nesh, të paktën, mendojnë të bëjnë diçka për më pak mbetje, për të mos thënë sa prej nesh i ndajnë dhe i riciklojnë ato?

Në vijim, trokas hipotetikiqsh në derën e njësisë vendore. Pak rëndësi ka nëse jetoj në fshat apo në qytet, në rrethinë apo në qendër të Tiranës. Ngado, më së shumti, gjej vetëm përgjegjësinë për “numrin e kazanëve” dhe “cilësinë e pastrimit dhe të transportimit të mbetjeve”. Ndoshta, sepse edhe unë, si qytetar, pak interesohem se ku shkojnë 3-4 kg e mbetjeve ditore të familjes sime, më mjafton të largohen përgjeth e plehrave dhe të mos kundërmojë erë e rëndë. Në krizën e sotme, tarifa për mbetjet më duket e lartë.

Pak më vonë, habitem kur shoh në media se njësi vendore është gjobitur, nën arsyetimin se nuk ka marrë masa për landfill sanitar. Pikëpyetje të shumta mbi zgjidhjen

më të përshtatshme, vendin e duhur, fondet e investimit, etj., të paktën marrin disa përgjigje të pjesshme si “jo buzë lumit si më parë”, “jo çdo njësi me landfillin individual”, etj. Shumica mbeten pyetje që qëndrojnë pezull, jo prej vakuimit ligjor dhe as prej dëshirës për të gjetur zgjidhje.

Sa keq që jemi ende prapa në kohë, kur e shohim zgjidhjen tek detyra e pushtetit vendor për të hapur një venddepozitim dhe për të transportuar atje plehrat. Ndërkohë, groposim apo hedhim buzë lumenjve një pasuri të tërë burimesh, që duket e pavlerë për sa kohë nuk ndërrohet rrjedhën e saj drejt ripërdorimit apo riciklimit. Qartazi mungojnë disa hallka që do të lidhnin qytetarin, si furnitorin kryesor të lëndës së parë, me 60 kompanitë ekzistuese të riciklimit.

Endem të gjej zgjidhjen e ekuacionit të vështirë shqiptar të menaxhimit të mbetjeve, me të panjohurat “ndërgjegjësim”, “shërbim pastrimi”, “riciklim”, etj. Çuditërisht e kanë zgjidhur shumë vende të tjera, por ne rrekemi të debatojmë mbi zgjidhjet, më së shumti sipërfaqësore. Nga mënyra si i menaxhojmë mbetjet, fëmijët do të na quajnë jo-qytetarë, por edhe do të habiten me pamundësinë tonë për të kuptuar theshtësinë e problemit.

Raporti i progresit 2012: Reflektim mbi progresin e Shqipërisë në fushën e mjedisit


Genta Hoxha
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

Në 10 tetor 2012 Komisioni Evropian publikoi opinionin e tij vjetor mbi politikën e zgjerimit të Bashkimit Evropian dhe raportimin mbi progresin e deritanishëm të arritur nga çdo vend për këtë vit. Po atë ditë u bë publik dhe Raporti i Progresit për Shqipërinë për 2012-ën.

Edhe ditë më vonë pas publikimit, media shqiptare dhe debatet politike ishin tërësisht të fokusuar te reformat ende të paplotësuara për të marrë statusin e plotë të vendit kandidat. Asnjë shpjegim nuk u përmend për mjedisin. Ndërkohë që vlerësimi i përgjithshëm i bërë në Raportin e Progresit për 2012-ën, përta i përket mjedisit në vend përshkruhet si “pak progres”.

“Përpjekjet janë urgjentisht të nevojshme për përafrimin, zbatimin dhe fuqizimin e legjislativës. Ndërgjegjësimi publik dhe konsultimet mbi nismat legjislative apo investimet publike mbeten të dobta. Ka nevojë për më shumë angazhim politik dhe veprime të koordinuara brenda këtyre sektorëve. Nevojiten investime të konsiderueshme, ndërsa alokimi i burimeve aktuale mbetet i kufizuar. Mjedisin duhet të integrohet më mirë në fusha të tjera politikash, të tilla si energjia dhe transporti. Sa i përket ndryshimeve klimatike, kërkohen përpjekje të dukshme mbi rritjen e ndërgjegjësimit, krijimin e një përfaqëseje më strategjike për vendin, përafrimin dhe zbatimin e acquis, si dhe forcimin e kapaciteteve administrative dhe bashkëveprimin ndër institucional. Përgatitjet në fushën e mjedisit janë ende në fazën fillestare, ndërsa ato në fushën e ndryshimeve klimatike mbeten në një fazë shumë më të hershme”, janë konkluzionet e raportit për pjesën e mjedisit.

Në një reflektim mbi progresin e fushave kryesore të mjedisit, gjatë vitit 2012 në krahasim me vitin 2011, REC Shqipëri paraqet grafikun në vijim.



Të shpëtojmë atë pak që na ka mbetur!

Themi Perri

Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë

Në shtypin e ditës (dhe jo vetëm) dëgjon jo rrallë lajme të shfarrosjes së faunës së egër për shkak të gjuetisë së paligjshme nga gjuetarë të licënuar (ose jo), banorë vendas apo shtetas të huaj, si dhe nga individë të veçantë të apasionuar pas këtij “sporti”. Ky problem është bërë përherë e më shqetësues, tashmë në disa qytete të Shqipërisë. Me gjithë legjislacionin në fuqi, ligji “Për gjuetinë” i vitit 2010-ës dhe “Për mbrojtjen e faunës së egër” i 2008-ës, si dhe shtesat dhe amendimet që u janë bërë këtyre të fundit, pak po bëhet nga ana e institucioneve përkatëse për zbatimin e tij në mbarë vendin dhe ndalimin e këtij fenomeni në dëm të mjedisit.

Me kohë Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë ka dhënë alarmin për mënyrën e sjelljes dhe të ushtrimit të gjuetisë nga agjencitë “turistike”, që vetëm turistike nuk mund të jenë. Ato gjuajnë në kohë e pa kohë, vrasin sa të duan dhe ku të duan, përdorin të gjitha mjetet e sofistikuara, imituesat, kurthet, stampat e çdo gjë tjetër të ndaluar me ligj në gjithë botën, duke mbushur thasët me kafshë e shpendë të egra e çuar në vendin e tyre për të bërë biznes. Pa përmendur këtu gjuetarët ilegalë, të cilët vijnë me shumicë me ndihmën e shqiptarëve që jetojnë e punojnë jashtë vendit.

Si ka mundësi që këto “agjenci” të operojnë në vendin tonë, kur është ende në fuqi një marrëveshje e BE-së që në shtetin e Italisë nuk mund të futen produkte të mishit nga Shqipëria? Mos vallë me vetëdije apo pa dashje po kontribuojmë në lulëzimin e një fenomeni që e ka emrin kontrabandë?

Nga informacionet që disponon kjo federatë, por dhe nga takimet me specialistë e banorë të zonave, këtë vit për shkak dhe të dimrit të pazakontë, fauna e egër është dëmtuar në masë të konsiderueshme. Në mënyrë të veçantë thëllëza e malit, ku dëshmitarë të zonave tregojnë se kur shkriu bora janë gjendur tufa të tëra me thëllëza mali të ngordhura.

Sikur të mos mjaftonte kjo, lejimi i “agjencive” turistike për të ushtruar veprimtarinë e tyre në Tropojë, Kukës, Has, Dibër e gjetkë, do të kontribuonte të zhdukej edhe ajo pak që ka mbetur, duke rrezikuar seriozisht zhdukjen e thëllëzës së malit si lloj. Duhet të luftohet për të mbrojtur këtë pasuri publike, që në asnjë mënyrë këto “agjenci” të mos lidhin kontrata me këto rrethe,

ashtu sikundër kërkohet ndihma e organizatave mjedisore, e shoqatave për mbrojtjen e mjedisit dhe natyrës, e specialistëve të fushës që gjithë jetën e tyre ia kanë përkushtuar florës dhe faunës së egër, të ngrënë zërin e të denoncojnë pranë organeve shtetërore këto veprime me pasoja të pariparueshme për botën e egër.

Federata e Gjuetarëve të Shqipërisë kërkon nga strukturat shtetërore të mbështesin punën vullnetare të komunitetit të gjuetarëve për mbrojtjen e faunës së egër, por edhe miratimin e amendimeve të ligjit të gjuetisë propozuar nga vetë ajo ku, mes të tjerash, është moratoriumi për ndalimin e gjuetisë të të huajve për katër vite (kjo nuk e pengon integrimin e Shqipërisë në BE, përkundrazi) dhe po për katër vjet ndalimin e tregëtimit të mishit të kafshëve dhe shpendëve të egra, pasi gjuetia kohët e fundit është kthyer në një biznes të pastër. Duke sakrifikuar pasionin e tyre për gjuetinë, ata bëjnë thirrje për të ndaluar zona të tëra gjuetie në shkallë rrethi apo qarku, për një a dy vjet, për të bërë të mundur rehabilitimin dhe kthimin në identitet të faunës së egër.



Lëvizjet qytetare dhe mbrojtja e mjedisit në Shqipëri

Ardian Hackaj & Bendis Bocari
Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim

Në Shqipëri, shumë vendime për mjedisin merren në nivelin qendror të qeverisjes. Edhe pse legjislacioni kombëtar u jep mundësi qytetarëve të marrin pjesë në vendimmarrje, kjo në realitet nuk ndodh. Ndikimi në vendimmarrje është një sfidë e vërtetë për qytetarët dhe bashkësitë lokale, për më tepër kur janë ata që preken më së shumti nga këto vendime. Në këto raste, lëvizjet qytetare kontribuojnë në një shoqëri të shëndetshme civile dhe në një lidhje më të mirë mes individëve në shoqëri dhe në shtet. Në Shqipëri, lëvizjet qytetare janë dukuri të reja, që lindin kryesisht si reaksione të bashkësive të ndryshme, në shenjë proteste kundër ndotjes së mjedisit me efekte të dëmshme tek protestuesit.

Në linja të përgjithshme, aksionet në mbrojtje të mjedisit në Shqipëri ndahen në dy grupe kryesore:

A Nisma mjedisore, të cilat janë kryesisht projekte vertikale nga lart poshtë, me mbështetje financiare, të mirë organizuara dhe që formësohen në manifestime, konferenca, fushata informuese e ndërgjegjësuese, promovim kuadri ligjor, etj.

B Protesta mjedisore, të cilat lindin si reagim “kundër” një problemi lidhur me mjedisin dhe burojnë nga bashkësitë në nivel lokal. Krijimi i këtyre aksioneve dhe i grupeve që i mbështesin ato vjen në mënyrë të natyrshme dhe spontane, duke i bërë të dallueshme nga lëvizjet e dirigjuara nga strukturat tradicionale pushtetore. Duke qenë të tilla, këto klasifikohen si lëvizje qytetare dhe janë më të përshtatshme për të identifikuar, mbështetur ose parandaluar probleme të mjedisit apo të zhvillimit lokal.

Bazuar në një studim të kryer në gusht - shtator 2012 mbi pasqyrimin e “protestave mjedisore” nga mediat kombëtare, CDI-ja ka mundur të identifikojë disa nga shkaqet më të zakonshme që kushtëzojnë lindjen e lëvizjeve qytetare për mjedisin në Shqipëri. Këtu përfshihen reagimi ndaj dëmeve të pësuar nga asetet komunale (rrugët, pyjet, kullotat, burimet, etj) e që prekin direkt bashkësinë, grabitja ose keqpërdorimi i pasurive të bashkësisë lokale, hedhja e paligjshme e mbetjeve urbane dhe ndotja industriale. Të gjitha këto shkaqe prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë banorët, duke i bërë ata të reagojnë ndaj situatës, në mbrojtje të interesave të tyre dhe aseteve që shfrytëzohen historikisht nga bashkësia lokale.

Nga pikëpamja institucionale, lëvizjet qytetare në Shqipëri janë shumë të lokalizuara dhe i shërbejnë kryesisht individëve ose bashkësive të prekura në mënyrë të drejtpërdrejtë. Kjo situatë dhe shtrirja e tyre lokale bën që shumë pak nisma të ngrihen në nivel kombëtar. Vlen të përmendet këtu “Lëvizja qytetare e Vlorës” dhe “Aleanca kundër importit të plehrave”. Lëvizjet qytetare të identifikuar fokusohen në pasojat negative të rritjes ekonomike, në efektet keqbërëse të ndotjes industriale dhe urbane, në mbrojtjen e biodiversitetit nga aktivitetet ekonomike lokale. Si një formë dominuese e lëvizjeve qytetare mjedisore, CDI-ja ka identifikuar se protestat e banorëve lokalë përbëjnë mëse 60% të aksioneve, të ndjekura nga bllokimet e rrugëve, referendumet, sulmet fizike madje deri dhe sabotazhin e pajisjeve dhe të infrastrukturës, të menduara si shkaktarë të degradimit mjedisor.

Lëvizjet qytetare në Shqipëri kanë një shkallë të ulët institucionalizimi dhe mbështetje financiare të pastrukturuar. Ato fillojnë kryesisht si protesta spontane

të banorëve, për t’u mbështetur më vonë nga organizatat e shoqërisë civile (OShC), kryesisht për anën organizative dhe ndërgjegjësimin e publikut të gjerë. Kjo situatë e pasigurt ndërlikohet akoma më tepër nga profili i organizatave lokale - ato paraqesin një staf jo të paguar rregullisht, mbështetje financiare sporadike, bazë lokale shumë të ngushtë dhe mungesë koordinimi kombëtar apo ndërkombëtar. Për më tepër, qasja kryesisht reaguese e lëvizjeve qytetare lokale nuk i lejon ato të para-planifikojnë aktivitetet e nevojshme dhe shpenzimet përkatëse. Si të tilla, atyre u mungon struktura organizuese funksionale dhe pas vanitjes së energjisë fillestare, vuajnë nga “lodhja organizative” (A.Klosi për “Vlora Iniciativa Civile”) dhe në fund shpërbëhen.

Në përfundim, në Shqipëri lëvizjet qytetare janë një formë shumë e përshtatshme për sjelljen në vëmendjen kombëtare të problemeve dhe nevojave lokale mjedisore. Si të tilla, ato kanë për qëllim të lehtësojnë shqetësimet e bashkësive të prekura dhe janë format më eficiente për të trajtuar problemet lokale mjedisore. OShC-të lokale janë vektorë që zmadhojnë dhe rrisin qëndrueshmërinë në kohë të lëvizjeve qytetare. Megjithë mbështetjen shumë të madhe nga banorët lokalë dhe anën konkrete të aksioneve mjedisore të propozuara, kërkesat e tyre për mbështetje në të shumtën e rasteve janë të pasuksesshme. Kjo vjen kryesisht për shkak të rëndësisë që i japin donatorët kushteve të përzgjedhjes, ku më të rëndësishmet janë numri i stafit të përhershëm, buxhetet e viteve paraardhëse, udhëzimet për aplikim “shumë të komplikuar” etj.

Duke marrë parasysh rëndësinë e rolit dhe të përfshirjes së qytetarëve në mbrojtjen afatgjatë të mjedisit, strategjitë në favor të lëvizjeve qytetare dhe të organizatave lokale të shoqërisë civile mund dhe duhet të evoluojnë. Risitë që sigurojnë mbështetje edhe për ato nisma mjedisore, të cilat nuk paraqesin garancitë e organizatave të afirmuara profesionale, por që ofrojnë përqafim gjithëpërfshirës dhe energji qytetare për një aksion mjedisor të qëndrueshëm dhe relevant, do të plotësonin politikën e tanishme mjedisore në Shqipëri.

Përfshirja e shoqërisë civile në hartimin e programit SENiOR-A

Rezart Kapedani
Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

SENiOR-A Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri



TAKIMI RAJONAL SHKODËR - FOTO: REC

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, me mbështetjen e Qeverisë Suedeze, ka nisur zbatimin e programit të ri në mbështetje të shoqërisë civile, përgjatë tre viteve të ardhshme (2012-2015) me titull: Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENiOR-A).

Në mënyrë që të përfshihen sa më shumë anëtarë të shoqërisë civile, jo vetëm në zbatimin e programit, por dhe për të marrë idetë e tyre në hartimin e dokumentit të programit, REC Shqipëri organizoi 8 takime rajonale me pjesëmarrjen e organizatave të shoqërisë civile, kryesisht nga fusha e mjedisit, nga e gjithë Shqipëria.

Takimet e mbajtura përkatësisht në rajonet e Shkodrës, Kukësit, Fierit, Elbasanit, Korçës, Gjirokastrës dhe Tiranës rezultuan të suksesshme, jo vetëm në arritjen e objektivave të vendosura, por dhe në një pjesëmarrje të gjerë nga i gjithë komuniteti i OSHC-ve mjedisore e më gjerë. Në përgjithësi morrën pjesë rreth 150

anëtarë të shoqërisë civile, që përfaqësonin 102 OJF. Mjaft e kënaqshme ishte dhe shpërndarja gjinore, ku më shumë se 35 % e pjesëmarrësve ishin femra.

Takimet ofruan një platformë ndërvepruese në dhënien e një informacioni të detajuar mbi paketat e punës së programit SENiOR-A dhe marrjen e mendimeve prej pjesëmarrësve për një zbatim sa më të suksesshëm të këtij programi.

Ndër mendimet e ndryshme të shprehura nga anëtarët e OJF-ve mjedisore, të cilat u përfshinë dhe në planin e punës së programit, janë: (i) trajtimi i problemeve të menaxhimit financiar dhe fiskal që OJF-të hasin gjatë aktivitetit të tyre; (ii) trajtimi i OJF-ve nga REC edhe si partner, në rastin kur ato hasin vështirësi në ecurinë e punës së tyre; (iii) asistencë gjatë grant-dhënies në lidhje me qasjen e menaxhimit bazuar në rezultatet, hartimin e Kuadrit të Vlerësimit të Rezultateve (RAF) dhe të monitorimit të rezultateve; (iv) përfshirjen më të madhe të komunitetit dhe të zonave larg kryeqytetit dhe (v) trajtimin e rrjeteve si fleksibël, bazuar në tematikën dhe aftësinë e shtrirjes gjeografike.

Puna ka vijuar me ndërmarjen e një studimi, të fokusuar në rifreskimin e Adresarit të REC për OJF-të mjedisore dhe në vlerësimin e gjendjes, të nevojave dhe të problemeve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri. Deri më tani 80 OJF kanë plotësuar pyetësorët me të dhënat e tyre, duke mundur një përfshirje të gjerë të OSHC-ve në mbarë vendin. Gjithashtu, studimi do të ndihmojë dhe në përgatitjen dhe në planifikimin e formave të ndryshme të mbështetjes për OSHC-të, ofruar përmes programit SENiOR-A.

Programi SENiOR-A do të fillojë zbatimin e aktiviteteve të tij gjatë muajit nëntor, duke publikuar shumë shpejt thirrjet e ndryshme për përfshirjen e OJF-ve dhe të ekspertëve në elemente të ndryshme të tij.



“një mesazh
për ty”

Bashkëpunimi në menaxhimin e mbetjeve, një domosdoshmëri për njësitë vendore

Modeli i menaxhimit rajonal në uljen e kostove dhe tarifës për qytetarin

Eduart Cani

Qendra Rajonale e Mjedisit (REC), Shqipëri

Menaxhimi i mbetjeve është një problem disa drejtimësh, por mbi të gjitha ai është një problem financiar. Njësitë vendore në të gjithë territorin nuk kanë dhe nuk do mund të kenë së afërmi një sistem menaxhimi financiar, i cili të adresojë nevojën dhe të bëjë të ardhmen të qëndrueshme.

Deri më tani qytetarëve u faturohet vetëm tarifa për grumbullim dhe transport të mbetjeve, e cila në vetvete është në një vlerë të pamëshuar drejt dhe shumë e ulët për të mbajtur sistemin funksional. Për më tej, në mungesë të një sistemi funksional rajonal të grumbullimit dhe të depozitimit në fusha sanitare mbetjesh, nuk është përlogaritur akoma kostoja shtesë për qytetarin në depozitim të mbetjeve, e cila është një tarifë shumë më e lartë se ajo e para.

I gjithë ky sistem financiar, pa shtuar në të elementë të tjerë modernë apo kosto për trajtimin e mbetjeve të rrezikshme, është i pazhvilluar dhe i pastandardizuar, qoftë në nivel kombëtar, qoftë në nivel vendor.

Megjithatë, njësitë vendore kanë në funksion dhe grumbullojnë tarifën e mbetjeve në shifra nga më minimalet deri në ato të kënaqshme. Ky është dhe rasti në rajonin e Shkodrës dhe të Lezhës, ku në territorin e komunës Bushat është ndërtuar një fushë sanitare për depozitim të mbetjeve. Si rasti i vetëm i një fushe funksionale, është përlogaritur dhe një kosto depozitimi për ton, e cila është aktualisht 1.000 lekë (pa TVSH).

Bazuar në këtë realitet, analizën e bërë mbi menaxhimin e tarifës dhe ndarjen e qendrave të kostos, si dhe nevojën e ngutshme që ka sektori për të adresuar dëmin e madh mjedisor që përkeqësohet çdo ditë, "Programi për Decentralizim dhe Zhvillim Vendor"

dldp, angazhoi REC Shqipëri dhe Universitetin e Lozanës në Zvicër, për të ndërtuar një model infrastrukturor dhe financiar, i cili adreson pikërisht bashkëpunimin ndër-vendor dhe rajonal në rritjen e eficiencës financiare.

Ekipi punoi në periudhën Mars-Qershor 2012, në vlerësimin e gjendjes për 54 njësitë e Qarkut Shkodër dhe Qarkut Lezhë, bazuar në indikatorët e profilit rajonal të mbetjeve, kërkesave të Strategjisë së Mbetjeve dhe përvojës praktike të *dldp* në rajon.

Fokusuar në katër shtylla të menaxhimit -grumbullim; transport; depozitim dhe amortizim-, ekipi ndërtoi modelin e parë në vend, i cili analizon në hollësi të gjitha detajet e menaxhimit të shërbimit dhe gjen vlerën e tarifës që i adresohet secilit qytetar në këto dy rajone. Sistemi merr për bazë tarifën për depozitim në fushën rajonale të Bushatit dhe llogarit kostot operacionale, distancën, fuqinë punëtore, infrastrukturën, etj., për të kuptuar aftësinë paguese të këtij sistemi.

Studimi, i cili është paraqitur në konferencën kombëtare më 3 Korrik 2012, në Tiranë, gjeti se për shkak të shtrirjes gjeografike dhe të distancave nga fusha e depozitimit, tarifa varion nga 750 deri në 3.100 lekë për banorë në vit, me ndikimin më të madh në zërin e transportit. Sipas kësaj, për njësitë me numër banorësh nën 10.000, shërbimi është i pamundur të ofrohet nga vetë njësia, ndërkohë që me mbi 10.000 banorë kërkohet zgjidhje tjetër. Gjithashtu, njësitë me një distancë mbi 17 km nga fusha e depozitimit, duhet të paguajnë kosto transporti më të mëdha se vetë depozitimi. Ndërkohë, që për njësitë në distancë mbi 100 km, është e pamundur që mbetjet të vijnë në fushën e depozitimit.

Studimi analizoi më tej mundësitë dhe ndërtoi një skemë funksionimi rajonal, e cila vë në përdorim fushat e transferimit në pika kyçe të territorit (Rrëshen, Rrape, Koplik, Lezhë dhe Shkodër), duke ndërtuar forma bashkëpunimi ndër-vendore në ndarjen e shërbimit dhe kostove.

Kjo formë organizimi, e modeluar nga një sistem matematikor, mundëson uljen e tarifës deri në 40%, me një shpërndarje edhe më "fitim-prurëse" në disa prej fushave të transferimit, sidomos në atë të Rrëshenit me rreth 60%. Kjo ulje do të nënkuptonte uljen e tarifës mesatare për banor nga 1.600 lekë në 900 lekë, me përfitime shumë më të mëdha për njësitë e vogla. Me futjen e skemave më të mira, të cilat evitojnë mbetjet organike nga sistemi, ulja e kostos do të shkonte nga 900 në 700 lekë për banor në vit, kjo duke marrë parasysh se mbetjet në Shqipëri janë rreth 60% organike, çka nënkupton një ulje me rreth 30% të mbetjeve që shkojnë në skemën e menaxhimit.

Skema e menaxhimit me pika transferimi, përveç përfitimeve shumë të larta në uljen e tarifës, mundëson një ulje të shkarkimeve të CO₂ në atmosferë me 35% ose 1,1 milion kilogram në vit, krahasuar me skemën direkte.

Modeli i ndërtuar është unik dhe i përdorshëm nga të gjitha rajonet në Shqipëri, duke mundësuar një përlogaritje të përgjithshme për të gjithë koston e menaxhimit në nivel kombëtar. Ai i jep mundësinë njësitë vendore që, nëpërmjet bashkëpunimit, të ulin koston e menaxhimit dhe të rrisin eficiencën e shërbimit.

Vlerësimi është një kontribut i madh në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve, pasi shërben si një shembull i administrimit të shërbimit dhe optimizimit të tij, duke u përshtatur në kushtet gjeografike dhe infrastrukturën lidhëse rrugore.

Produkti i këtij studimi është në dispozicion të të gjitha njësitë vendore dhe këshillave të qarqeve në vend dhe gjendet pranë REC Shqipëri dhe *dldp*.

Problematika e mbetjeve urbane

Kadri Gega
Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

DJEGIE MBETJESH - FOTO: E. CANI

Kohët e fundit opinioni publik dhe ai mediatik është përfshirë në një debat mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta urbane, duke e konsideruar si një nga problemet më serioze me të cilat aktualisht përballet vendi. Reagimi për të përmirësuar situatën, si nga aktorët vendorë e qendrorë, është për t'u përhëndetur, aq më tepër nga fakti se kemi dy dekada që kemi hyrë në shoqërinë e ekonomisë së tregut dhe është normale që njerëzit, në radhë të parë janë përpjekur për të siguruar e konsumuar mallra për nevojat e tyre jetike dhe, tani vjen momenti që të kthejmë kokën pas e të mendojmë për atë që ka mbetur nga konsumi.



Shoqata e Bashkive të Shqipërisë e ka trajtuar këtë problem për një kohë të gjatë dhe vazhdon ta ketë në qendër të vëmendjes së saj. Ajo ka organizuar takime e seminare për të promovuar praktikat më të mira, madje ka qenë partnere kryesore në hartimin e manualit të mbetjeve urbane në njësitë vendore. Legjislacioni shqiptar për menaxhimin e mbetjeve urbane ka bërë hapa të mëdha përpara në përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian, por realiteti shqiptar paraqitet krejt ndryshe. Aktualisht, shërbimi i menaxhimit të mbetjeve të ngurta, kryesisht ato familjare, është totalisht autoritet i njërive vendore, i cili në pjesën më të madhe të tij merret me transportimin nga konteinerët e mbetjeve deri në vendgrumbullimin e caktuar, një aktivitet që, kur vendoset përballë standardeve të kërkuara të BE-së, vlerësohet se është në kuotë shumë të ulët. Ky shërbim, që në vetvete lë shumë për të dëshiruar, ofrohet ose nga strukturat bashkiake përgjegjëse për mbetjet e ngurta urbane, ose nga kompani private të kontraktuara nga vetë njësitë vendore. Në disa nga komunat as që mund të flitet për këtë problem, pasi për shkak të mundësisë së vogël financiare për ta mbuluar këtë shërbim, ato pak fonde që kanë në dispozicion tentojnë t'i përdorin për prioritete të tjera më të ngutshme.

Hapësira e ligjit dhe forca detyruese e tij i ka të gjitha mundësitë që, në kushtet aktuale, procesi i grumbullimit dhe i transportimit të mbetjeve të realizohet me sukses në të gjithë territorin. Angazhimi serioz i përbashkët i institucioneve qendrore, rajonale dhe vendore është kyçi i këtij suksesi. Duke iu referuar hierarkisë bashkëkohore paneuropiane të menaxhimit të integruar të mbetjeve, e cila përfshin parandalimin, riciklimin, ripërdorimin, rigjenerimin për prodhim energjie dhe në fund eliminimin e asaj që mbetet me anën e kompostimit apo proceseve të tjera, kuptojmë qartë se realiteti ynë është në fazën fillestare, shumë shumë larg asaj që kërkohet.

Shërbimi aktual i menaxhimit të mbetjeve në vendin tonë është i mbështetur në një masë të konsiderueshme në mbi 40% të financimit që kërkohet. Ai financohet përmes të ardhurave të gjeneruara nga tarifa e shërbimit, nga të ardhurat e tjera vendore dhe pjesërisht nga buxheti vendor përmes transfertave të pakushtëzuara nga qeveria qendrore. Në mbledhjen e tarifave, historia e kohës së shkuar dhe e asaj që aktualisht po përfshijmë nuk është në nivelin e kërkuar, sepse hartimi, miratimi dhe zbatimi i tarifave vendore nuk reflekton principin “ndotësi paguan”. Është e padiskutueshme që mbulimi i tarifës që vilet prej qytetarëve është një element i rëndësishëm për të përmirësuar gjendjen, por sot ajo është vetëm një tarifë që mbulon transportin e mbetjeve nga koshat grumbullues deri në fushën e mbetjeve.

Nëse do të marrim në konsideratë edhe proceset e tjera të hierarkisë së mbetjeve, atëherë do të kuptojmë se, në vetvete, të ardhurat nga tarifat asnjëherë nuk mund të mbulojnë shpenzimet për të realizuar këtë shërbim sipas standardeve të vendeve të BE-së. Procesi kërkon kohë, por koha nuk pret, nga njëra anë duhet të shpejtojmë por nga ana tjetër nuk duhet të ngutemi. Më e mira është të ecim para me të gjitha mundësitë, por

Nuk është vetëm një kryetar bashkie a qarku, apo një administrator qendror a vendor që e realizon këtë shërbim, janë një numër i madh aktorësh e faktorësh të lidhur në një proces të pandarë

jo me kënd të mënjanuar, pasi shkojmë atje ku nuk duhet. “Plaga” e mbetjeve, që të shërohet, kërkon të vëzhgohet me një përjasje holistike - të gjejmë shkaqet që në burim e të marrim masa që të shërojmë sëmundjen, duke mos hequr dorë nga përmirësimi i situatës, por të gjejmë zgjidhje emergjente me sa më pak kosto. Heqja, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve për në

vendet e përcaktuara është zgjidhja më emergjente, është detyrë e padiskutueshme e njërive vendore dhe, njëkohësisht, nuk duhet të ndërpriten masat detyruese e ndëshkuese, të zbatuara deri tani, ndaj aktorëve dhe faktorëve përgjegjës.

Kur flasim për një përjasje të qëndrueshme, nga sa kemi parë, dëgjuar e mësuar nga vendet e tjera të BE-së, kemi arritur në konkluzionin se e ardhmja për riciklimin, ripërdorimin dhe rigjenerimin për prodhim energjie i takon iniciativës private. Shteti është rregulluesi ligjor organizativ dhe administrativ i gjendjes përmes instrumenteve që i ka dhënë ligji. Por, shteti ka për detyrë të krijojë hapësirën e duhur për angazhimin e biznesit privat, i interesuar për mbetje të tilla si qelq, letër, plastikë, dru, skrap etj. Kjo do të bëjë të mundur që pjesa e mbetjeve që mbeten për t'u transportuar, trajtuar apo kompostuar, të zvogëlohet duke shkuar gradualisht në vlerën zero të mbetjeve. Aktualisht në Shqipëri operojnë 60 kompani ricikluese private, të cilat hasin vështirësi shumë të mëdha në vendosjen e raporteve me grumbulluesit dhe transportuesit e kontratuar nga bashkitë përkatëse. Biznesi privat ka filluar të realizojë që në vendet e grumbullimit procesin e ndarjes së mbetjeve, por kjo nuk mjafton. Realizimi me sukses i këtij procesi kërkon angazhim serioz nga familjet shqiptare, duke mos përjashtuar bizneset e mëdha dhe të vogla që operojnë në njësitë vendore. Nga ana tjetër, nuk duhet harruar se dora e institucioneve shtetërore si në nivel qendror, rajonal apo vendor, mendësia e tyre e trajtimit të problemit, si dhe reagimi i tyre është tejmasë i domosdoshëm. Venddepozitimet, që trumpetohen me të madhe në media, janë zgjidhje emergjente e situatës që po kalojmë, nuk janë zgjidhje afatgjatë e qëndrueshme.

Qëndrueshmëria e realizimit me sukses të menaxhimit të mbetjeve mbështetet në dy drejtime kryesore. Drejtimi i parë është ushtrimi i forcës kontrolluese dhe ndëshkuese, që

Të mos harrojmë që të gjithë jemi konsumatorë dhe si të tillë ne krijojmë mbetje, të gjithë jemi bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës, asnjë person nuk mund ta mendojë veten të përjashtuar nga ky fenomen.



MBETJE PËRGIJATË LUMIT BUNAVSHKODËR - FOTO: E. CANI

rrjedh nga forca e ligjit për zbatim nga ana e institucioneve qeverisëse qendrore e vendore. Strukturat përgjegjëse shtetërore e kanë për detyrë të mos rreshtin asnjëherë së punuari, duke vendosur gjokat apo masat e tjera shtrënguese e detyruese për drejtues titullarë, për njerëz të thjeshtë, për institucione publike apo private, duke shkarkuar nga detyra punonjës që merren direkt me këtë shërbim në qendër dhe në bazë, duke i hequr të drejtën kompanive të kontraktuara që nuk kanë performancën e kërkuar apo duke marrë masa të tjera ndëshkuese ligjore për të gjithë ata që ndotin dhe nuk paguajnë.

Drejtimi tjetër është ndërgjegjësimi i qytetarëve, i cili në fakt fillon që në bankat e shkollës me tekstet që duhet të promovojnë kulturën për trajtimin e mbetjeve. Por, edhe bizneset e vogla apo të mëdha mund të përshtasin rregulla detyruese në mbrojtje të mjedisit, apo nëpërmjet propagandimit të praktikave më të mira, organizimit të aksioneve apo fushatave promovuese pozitive etj... Të mos harrojmë që të gjithë jemi konsumatorë dhe si të tillë ne krijojmë mbetje, të gjithë jemi bashkëfajtorë dhe bashkëvuajtës, asnjë person nuk mund ta mendojë veten të përjashtuar nga ky fenomen.

Forma klasike e krijimit të klimës pozitive me anë të fletushkave, revistave, gazetave dhe gjithë mjeteve të tjera të propagandës, janë pjesë e domosdoshme e këtij procesi. Mesazhi që duhet të japin njësitë vendore, së bashku me organizatat që mbrojnë mjedisin, ka për detyrë të bëjë të mundur që njerëzit të kuptojnë se një nga arsyt e rritjes së numrit të sëmundjeve është mjedisi i ndotur ku jetojmë. Lufta për një mjedis të pastër është lufta për një jetë më të shëndetshme.

Nuk është vetëm një kryetar bashkie a qarku, apo një administrator qendror a vendor që e realizon këtë shërbim, janë një numër i madh aktorësh e faktorësh

që janë të lidhur në një proces të pandarë. Për shembull, hartimi dhe planifikimi i territorit për trajtimin e mbetjeve, ku përfshihet përcaktimi dhe miratimi i vendeve të grumbullimit sipas standardeve të kërkuara, kërkon angazhimin jo vetëm të qeverisjes lokale - bashki dhe komuna, por edhe asaj rajonale e qendrore. Ndërtimi i venddepozitimeve dhe menaxhimi i tyre është plotësisht në varësi të qarqeve, por qarqet nuk mund të bëjnë asnjë hap pa angazhimin e qeverisjes qendrore. Janë disa bashki, të cilat i grumbullojnë mbetjet afër lumenjve apo përrrenjve, se ashtu kanë vepruar për vite me radhë, por kanë harruar se të gjithë lumenjtë derdhen në det dhe detin ne e promovojmë me të madhe si mundësi zhvillimi turistik. Fakt shumë i rëndë, për të cilin flitet shumë dhe është bërë shumë për ta shmangur, por rezultatet nuk janë ato që kërkohen. Koha kërkon njerëz dhe njerëzit dallojnë nga kafshët jo vetëm nga mënyra se si hanë, por edhe nga mënyra se si kujdesen për të trajtuar atë që lënë nga pas.

Menaxhimi Lokal dhe Rajonal i Mbetjeve në Shqipëri

Sfida dhe mësim të nxjerra në planifikim dhe zbatim

Arben Kopliku

Programi për Zhvillim dhe Decentralizim Vendor (dldp)

Programi për Zhvillim dhe Decentralizim Vendor (*dldp*) prej vitesh punon në qarqet e Shkodrës dhe të Lezhës, për të forcuar kapacitetet e bashkive dhe të komunave, për të kontribuar më tej në përmirësimin e zhvillimit rajonal dhe në reformën për decentralizim në Shqipëri. Një nga fushat e mbështetjes së *dldp* për njësitë vendore në këto qarqe është përmirësimi i shërbimeve publike, me fokus të veçantë menaxhimin e mbetjeve urbane.

Përvoja nga puna konkrete në terren ka treguar se ka patur rezultate të mira, por edhe sfida të konsiderueshme, duke parashtruar nevojën urgjente për të zhvilluar dhe shpërndarë zgjidhjet e drejta e të përballueshme, duke vënë në praktikë planin dhe politikën kombëtare.

Konferenca kombëtare, organizuar nga Ministria e Brendshme dhe Agjencia Zviceriane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, në kuadër të “Programit për zhvillim dhe decentralizim vendor” (*dldp*) në korrik 2012, shërbeu si një platformë e rëndësishme për të ndarë, shkëmbyer dhe diskutuar përvojat dhe sfidat për përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve në Shqipëri.

Menaxhimi i mbetjeve u cilësua nga Ambasadorja zviceriane në

Tiranë, znj. Yvana Enzler, si një aspekt kyç i zhvillimit, që bën thirrje për më shumë veprim dhe iniciativë nga autoritetet e zgjedhura në nivel rajonal dhe vendor. “Unë jam e bindur se duke marrë këto e të tjerë shembuj dhe duke i përshtatur ato me gjendjen e secilës prej zonave tuaja, së shpejti do të mund të shohim qytete dhe fshatra të pastër, qytetarë më të kujdesshëm dhe turizëm e potenciale për investim në rritje”.

Zëvendësministri i Brendshëm, z. Ferdinand Poni, theksoi vendosmërinë e qeverisë për të promovuar menaxhim më të mirë të mjedisit dhe të mbetjeve, si dhe bashkëpunimin e suksesshëm me disa institucione dhe donatorë ndërkombëtarë.

Ajo çka u evidentua qartë dhe në konferencë, është nevoja për standarde kombëtare bazë për shërbimet në menaxhimin e mbetjeve dhe një sistem monitorimi për të ndjekur zbatimin e tyre. Për të patur efekt, politikën kombëtare duhet të promovojnë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar, zgjidhjet ndër-Njësive të Qeverisjes Vendore (NJQV) dhe përjashtet rajonale. Nga ana tjetër, qeveria duhet të planifikojë dhe të ofrojë mundësi/zgjidhje për depozitim dhe infrastruktura kryesore për transferim dhe transport në nivel rajonal/nën-rajonal. Zgjidhjet efektive dhe të përballueshme kërkojnë një bashkëpunim ndër-NJQV-ve (mbledhja, transporti, stacionet e transferimit nën-rajonal).

Për të arritur të gjitha këto, ka nevojë të madhe për mbështetje fillestare investimesh, veçanërisht për infrastrukturën bazë, si kazanë dhe mjete teknologjike, stacione transferimi dhe venddepozitime rajonale. Mbështetja duhet lidhur me performancën në shërbim dhe në mbledhjen e tarifës, mundësisht me vullnetin e mirë për bashkëpunim ndërkombëtar/rajonal. Është urgjente rritja e angazhimit të NJQV-ve, që të rrisin gradualisht nivelin e mbledhjes së tarifave dhe përqindjen e mbledhjes. Testimi i mënyrave të reja dhe i agentëve për mbledhjen e taksave (privatë apo publikë), zbatimimi i mëtejshëm i parimit “ndotësi paguan” (në veçanti për bizneset) shikohen si alternativa të mira.

Duke patur parasysh nevojën për pilotime të mëtejshme dhe përvoja në nivel lokal, ndër-NJQV-ve dhe nivel rajonal, disa shembuj nga brenda Shqipërisë dhe vendet e tjera mund të shërbejnë si modele, të cilat mund të përdoren nga qeveria vendore dhe rajonale gjatë në vend. Qarqet e Shkodrës e Lezhës kanë të gjithë potencialin që të shërbejnë si modele pilote për të vënë në zbatim politikën kombëtare.





FUSHA E MBETJEVE BUSHAT - FOTO: A. KOPLIKU

“Landfilli” rajonal i Bushatit

Zija Gerbeti

Administrator i Landfillit rajonal të Bushatit

Me investimin e bërë për ndërtimin e Landfillit të Bushatit, mjedisi për bashkitë e Lezhës dhe të Vaut të Dejës, komunat Dajç dhe Hajmel të Shkodrës, si dhe komunat Dajç dhe Blinisht të Lezhës, por dhe në zonën ku operon Ndërkomunalja e Zadrimës, ka pësuar një përmirësim të dukshëm. 12.000 ton mbetje, të larguara nga rrugët, kanalet dhe mjediset e tjera të këtyre komunave e bashkive, janë depozituar dhe menaxhuar në landfill, duke ndryshuar ndjeshëm pamjen e zonave, duke krijuar një mjedis më miqësor e më të rehatshëm për jetën e banorëve.

Aktualisht në landfill gjenden të depozituara 60.000 m³ mbetje, ndërkohë që Bashkia e Shkodrës ende nuk ka depozituar mbetjet e veta në këtë landfill.

Për menaxhimin e këtij venddepozitimi është krijuar një ndërmarrje e veçantë, e cila mundëson një menaxhim bashkëkohor, me objektiv kryesor të saj përmirësimin e treguesve mjedisorë. Me qëllim që ndikimi në mjedis të jetë shumë i vogël, ndërmarrja po menaxhon me kujdes të gjitha mbetjet, lëngun kullues, gazrat që prodhohen nga to etj.

Për mbarëvajtjen sa më të mirë të punëve, është lidhur një akt-

Disa të dhëna për Landfillin e Bushatit:

Fondi i investimit:

4.2 milion euro, dhënë nga buxheti i shtetit

Popullsia të cilës do t'i shërbejë:

200.000 banorë

Periudha e shërbimit:

20 vjet

Sasia mesatare e mbetjeve që do të depozitohen:

130 ton në ditë

marrëveshje me të gjitha komunat dhe bashkitë e përfshira në studimin e depozitimit të mbetjeve në Bushat, për të sjellë mbetjet në këtë landfill. Një memorandum mirëkuptimi është lidhur dhe me bashkinë e Shkodrës, me pjesëmarrjen e aktorëve të drejtpërdrejtë të përfshirë në proces - komunat dhe bashkitë respektive, këshillat e qarqeve Shkodër e Lezhë, si dhe përfaqësues nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

Një studim i ndërmarrë nga USAID mbi koston për 1 ton mbetje të depozituar në landfill, tregoi se çmimi për 1 ton mbetje në landfill ishte 7 euro për një sasi prej 130 ton mbetje në ditë. Çmimi i studimit gjatë ndërtimit të këtij landfili doli 18 euro. Fakti që në landfillin e Bushatit vijnë mesatarisht 10-15 ton mbetje në ditë, shumë më pak nga parashikimet e bëra, bën që kostoja e menaxhimit të këtyre mbetjeve të rritet disa herë, pasi sa më e vogël sasia e depozitimit aq më e madhe del tarifa e menaxhimit të mbetjeve.

Megjithatë, puna vijon me seriozitetin e duhur dhe këtë e tregon më së miri funksionimi i rregullt i peshores në hyrje të landfillit. Mbetjet urbane janë më të rrezikshme kur grumbullohen në një vend të papërshtatshëm dhe nuk menaxhohen siç duhet.

Fakti që banorët kërkojnë kazanë për të hedhur mbetjet dhe tashmë ata janë ndërgjegjësuar për tarifat e pastrimit, do të thotë se ata e duan këtë shërbim.

A jemi ne në nivelin e kërkesave të banorëve? Ndoshta duhen kombinuar më mirë rritja e ndërgjegjësimin të qytetarëve me detyrimet ligjore për mjedisin. Shqipëria turistike detyrimisht kërkon një mjedis të pastër. Mjedisin e pastër është një nga problemet e rëndësishme për përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Politikë-bërja me pjesëmarrje për menaxhimin e mbetjeve në Shqipëri

Sherif Lushaj

Qendra e Studimeve të Burimeve Natyrore

Menaxhimi i mbetjeve është përgjegjësi direkte e autoriteteve shtetërore, por rol të rëndësishëm kanë të gjithë aktorët dhe faktorët e një shteti. Në këtë kuadër vjen dhe roli i shoqërisë civile, si përfaqësuesja më e gjerë e interesave të shoqërisë, por dhe si përcjellëse e ideve moderne e gjithëpërfshirëse.

Në kontributin e saj për ndërtimin e një qeverisjeje të mirë në menaxhimin e mbetjeve, Qendra e Studimeve të Burimeve Natyrore, në kuadër të programit slllovak-Balkan Public Policy Fund, ka hartuar një dokument politikash, në diskutim të gjerë me aktorët kyç në këtë sektor.

Në vlerësimin e gjendjes, dalin në pah një numër i madh sfidash, të cilat kërkojnë një punë të konsiderueshme si në aspektin njerëzor, institucional ashtu dhe në aspektin financiar. Më konkretisht, vërehet se menaxhimi i mbetjeve përbën një problem të rëndë mjedisor me progres të ulët, edhe pse kuadri ligjor dhe strategjik ka bërë progres, ligjet dhe strategjitë janë zbatuar në nivele të ulëta. Gjithashtu, analiza nxjerr në pah se politikat qendrore nuk përputhen me veprimet e qeverisjes vendore, duke e shkëputur zinxhirin e domosdoshëm të funksionimit koherent. Më tej vërehet se sektori i mbetjeve është i pambështetur financiarisht, mungon koordinimi i institucioneve e për pasojë niveli i menaxhimit është i dobët, për të përfunduar me venddepozitimet që janë jashtë çdo standardi mjedisor dhe shëndetësor.

Në thelb, dokumenti kërkon që Qeveria ta shpallë sektorin e mbetjeve në krye të listës së prioriteteve mjedisore, të hartohen standardet e shërbimit dhe komuniteti të vendosë për nivelin e standardeve kundrejt tarifës së shërbimit. Gjithashtu, sugjerohet funksionimi i komiteteve publike për sensibilizimin e publikut dhe pjesëmarrjen e tij në vendimmarrje, si dhe një strategji afatgjatë për ndërgjegjësimin e publikut.

Si pjesëmarrës aktiv në analizën e situatës dhe në takimin për vlerësimin e dokumentit, Prof. Lufter Xhuveli, këshilltar i kryeministrit për mjedisin dhe bujqësinë (ish ministër i bujqësisë dhe mjedisit 1997-2009) u shpreh se e vlerësonte shumë punën e bërë nga organizata në këtë drejtim, duke theksuar se “takimi ishte përtej parashikimeve, ishte profesional si në përmbajtje dhe në pjesëmarrje. Rekomandimet që ju i prezantuat këtu, presim t’i adresoni sa më parë pranë institucioneve qendrore, për t’u përfshirë në procesin e vendimmarrjes së organeve qendrore”.

Në rekomandimet e veta, të cilat u dakortësuan në një takim të gjerë me aktorë përgjegjës si Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave dhe Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, përfaqësues të bashkive dhe komunave, ekspertë e shoqëri civile, dokumenti i politikave përmend si të rëndësishme këto çështje:

- Përmirësimi dhe përputhja e politikave qendrore dhe vendore e menaxhimit të mbetjeve;
- Mbështetja me financime nga buxheti i shtetit, donatorët dhe taksat mjedisore;
- Reforma institucionale në inspektoriatet e kontrollit dhe njësitë që drejtojnë sektorin e mbetjeve në institucionet qendrore dhe vendore;
- Ngritja e kapaciteteve menaxhuese, trajnimet, zgjerimi i njohurive në programet shkollore dhe përgatitja e ekspertëve për mbetjet (nuk ka fakultet ose departament për mbetjet);
- Rritja e tarifës së shërbimit dhe hartimi i disa rregulloreve që mungojnë;
- Mungesa e landfillleve sanitare të hapura dhe pa standarde mjedisore, si dhe ndërtimi i landfillleve të reja;
- Rishikimi i objektivave të Qeverisë në nivel kombëtar për organizimin e menaxhimit rajonal të deritanishëm të mbetjeve dhe organizimin e landfillleve në përputhje me koston e menaxhimit të llogaritur për njësitë vendore;
- Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit të komunitetit, e rolit të shoqërisë civile, edukimi mjedisor në nivel kombëtar dhe vendor.

Zadrimë, të dua të pastër!

Zef Vokri

Shoqata "Ndërkomunalja e Zadrimës"

NGAAKTIVITETET NË KOMUNITET - FOTO: ZADRIMA



Shoqata "Ndërkomunalja e Zadrimës" lindi si produkt i një bashkëpunimi ndërkomunal, e modeluar sipas shoqatës simotër italiane, Circondaria e Val di Cornia-s, falë një projekti të COSPE-s, në mbështetje të komunave të Bushatit, Dajçit dhe Blinishtit, me objektivi të qartë orientimin e vëmendjes te problemet sociale dhe mjedisore. Meqënëse Zadrima, historikisht me bukuri të veçanta natyrore, u la në harresë për shumë kohë, vetë koha shtronte detyrën, jo vetëm të ringritjes ekonomike, por edhe të rivlerësimit të territorit, të ruajtjes dhe mbrojtjes së tij nga degradimi. Në të njëjtën kohë, ndryshimet ekonomike dhe hapja me botën krijuan kushte dhe standarde të reja, por edhe mbetje. Grumbuj të pafund hedhurinash, veçanërisht ambalazhe, enë plastike dhe copa plasmasi filluan të vërshojnë dhe zaptojnë rrugët dhe sheshet tona, duke shqetësuar edhe kalimtarin më indiferent. Në këto kushte, në 2009-ën filloi zbatimi i projektit "Mbështetje dinamike të zhvillimit lokal në zonën rurale të Zadrimës-Shqipëri e Veriut", financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Italisë, zbatuar nga COSPE, në partneritet me shoqatën "Ndërkomunalja e Zadrimës". Komponenti kryesor i projektit ishte ofrimi i shërbimit të mbledhjes dhe largimit të mbetjeve. Për këtë, u krijua një Njësi ekonomike pranë shoqatës, e cila operon në 20 fshatra dhe aktualisht është në proces zgjerimi. Komunitat, nga ana e tyre paguajnë kostot operative të shërbimit, ndërsa projekti ofron investime me kazanë për mbetjet dhe kamion teknologjik për mbledhjen dhe transportin e tyre; si dhe asistencë teknike e ngritje kapacitetesh për stafin e shoqatës.

Falë këtij bashkëpunimi, mund të thuhet se është arritur forcimi institucional i shoqatës, por edhe i stafit të komunave. Po krijohen mjedisë më të pastra nëpërmjet ofrimit të shërbimit të pastrimit të mbetjeve, sensibilizimit të publikut dhe edukimit të të rinjve në kopshte e shkolla për domosdoshmërinë e mbajtjes pastër të mjedisëve dhe ndikimin negativ të mbetjeve në jetën njerëzore.

Projekti ka finalizuar rikonstruksionin e pesë kopshteve model për fëmijët 3-6 vjeç, me edukatore të specializuara në fushën sociale dhe atë të mjedisit. Po ndërtohen dhjetë parqe publike, dy për secilën komunë, me pemë dekorative e lule, duke realizuar hapësira çlodhëse për komunitetin. Po punohet për të ndërtuar dy parqe të mbrojtura, njëri rreth liqenit të Vaut të Dejës dhe tjetri në perëndim të Komunës Bushat, në kufi me Velipojën.

Në 4-5 fshatra, për çdo komunë, janë vendosur kazanë mbetjesh dhe rregullisht kryhet shërbimi i mbledhjes, transportimit dhe depozitimit të tyre. Së shpejti fillon dhe mbledhja e diferencuar e plastikës, presimi i saj dhe tregtimi në ndërmarrjet ricikluese.

Një grup të rinjsh dhe të rejash animatore përcjellin derë më derë mesazhin e një jete më të mirë dhe cilësore, për një Zadrimë më të bukur. Në fokus kanë qenë dhe aktivitetet me grupe të ndryshme të interesit, veçanërisht nëpër shkolla, me punime artistike me materiale të ripërdorura, panairë, aktivitete argëtuese, konkurruese dhe edukative. Në Ditën Botërore të Territoreve të pastra, janë realizuar aktivitete masive, "Të pastrojmë botën", në shtatë fshatra për heqjen e të gjitha mbetjeve në rrugë e sheshe, në vendgrumbullime të paligjshme apo stoqe.

Grupi i të rinjve dhe të rejave animatore frymëzuan një lëvizje të gjerë sensibilizuese me sloganin "Zadrima, toka jonë", "Zadrimë, të dua të pastër", duke evokuar figura e ngjarje historike madhore, por dhe duke treguar si ta duam dhe ta mbrojmë territorin, ta vlerësojmë atë, të krijojmë një jetë më cilësore, me mjedisë të bukura e të pastra, duke bërë apel se përgjegjësia për mbrojtjen e mjedisit i përket secilit individ.

Ne tani po tentojmë drejt një objektivi edhe më ambicioz, për të prodhuar sa më pak mbetje. Komunitat kanë përcaktuar vendet e depozitimit për mbetjet inerte, ndërsa ato organike i përdorin si ushqim për blegtorinë ose i kompostojnë. Ka përpjekje për të përdorur më pak materiale plastike, duke synuar të tjera materiale, si qelqi, që mund të ripërdoren shumë herë. Kjo do të ulë edhe koston e transportit dhe të depozitimit të mbetjeve, e në fund të fundit edhe tarifën e shërbimit.

Komuniteti po i gëzohet çdo ditë ndryshimit, mjedisëve më të pastra dhe më të bukura. Njerëzit po e hedhin shikimin edhe përtej derës së oborrit, tek rruga, sheshi apo edhe kanali ku i hidhnin më parë mbetjet.



A Local Biodiversity Action Planning Network in the Western Balkans

Një rrjet i Planifikimit Lokal të Veprimit për Biodiversitetin në Ballkanin Perëndimor



Si vazhdim i projektit tre vjeçar "Biodiversiteti dhe Shërbimet e Ekosistemit për Zhvillim lokal të qëndrueshëm në Ballkanin Perëndimor (SEE BAP)" (Janar 2008 – Dhjetor 2011), ECNC-Qendra Evropiane për Ruajtjen e Natyrës në bashkëpunim me REC-Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore kanë nisur zbatimin e fazës së dytë të projektit në 8 njësi të reja bashkiake në 6 shtete të Ballkanit Perëndimor, me përfshirjen aktive të administratës lokale, biznesit të zonës dhe shoqërisë civile. **Në Shqipëri projekti ka nisur punën me komunat Margegaj dhe Bujan në rrethin e Tropojës.**

Kjo fazë e dytë e projektit ka për qëllim të nxisë shkëmbimin ndërkufitar dhe bashkëpunimin rajonal mes bashkive fqinje. Një përfaqje gjithëpërfshirëse dhe e integruar ndaj biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit është një element i rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm në të ardhmen të njësisve rurale dhe komunitetit të tyre në Ballkanin Perëndimor.

Fushat e veprimit:

- Përfaqja e integruar ndaj zhvillimit social-ekonomik dhe përdorimit të qëndrueshëm të biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit
- Ngritja e kapaciteteve – kusht i rëndësishëm për një sukses të veprimeve lokale
- Përfaqja bazuar te të drejtat – balanca dhe ekuilibri përfaqësues
- Biodiversiteti dhe ekosistemet si drejtues për biznesin lokal
- Bashkëpunimi ndërkufitar
- Ndryshimet klimatike si çështje ndërlidhëse
- Rritja e fondeve dhe menaxhimi i projektit

Objektivi kryesor:

Projekti synon të kontribuojë dhe të sigurojë mbështetje për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit, me qëllim përfshirjen e këtyre elementëve në planifikimin vendor dhe në vendimmarrje për të nxitur zhvillimin e biznesit lokal (ekonomia e gjelbër) në përfitimin e një zhvillimi ekonomik lokal të qëndrueshëm për njësitë rurale dhe komunitetet e tyre në Ballkanin Perëndimor.

Në mënyrë më të detajuar, objektivat fokusohen në planifikimin e mbrojtjes së biodiversitetit, menaxhimin dhe investimet.

Rezultatet e pritshme:

Projekti do të fokusohet në integrimin e biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit për bashkitë përfituese, çka do të reflektojë prioritetet vendore, kombëtare dhe ndërkombëtare dhe do të sjellë kushte më të mira jetese për grupet e synuara, përmes krijimit të vendeve të punës dhe rritjes të të ardhurave në rajon.

Në kuadër të maksimizimit të mësimave të nxjerra nga projekti i parë dhe sigurimit të efektivitetit optimal në dorëzimin e projektit, rezultatet e pritshme të këtij projekti janë:

1. Koordinatorët, ekipi, grupet e punës, grupet e aktorëve të përfshirë në këtë projekt të trajnuar për të menaxhuar dhe zbatuar PLVB-të në bashkitë partnere
2. PLVB-të të përgatitura dhe të miratuara përmes një procesi të hapur dhe transparent konsultimi shumëpalësh dhe arritje konsensusi në çdo bashki partnere, në përputhje me Udhëzuesin e PLVB-së
3. Veprime prioritare pilote të PLVB-ve të zbatuara me sukses, me mbështetjen e projektit në njësitë partnere
4. Përcaktimi dhe përdorimi i mekanizmave të qëndrueshëm për rrjetëzimin dhe shpërndarjen e rezultateve të projektit dhe të përvojave brenda dhe midis vendeve në rajon
5. Zyrtarizimi i proceseve të PLVB-ve në sistemet e planifikimit vendor në nivel kombëtar në çdo vend partner

“Nga rubineti”

Film dokumentar kundër prodhimit dhe konsumit në masë të ujit të ambalazhuar në shishe

Nga Nathan Johnson

Përgjatë një harku kohor prej vetëm tre dekadash, shitja e ujit të ambalazhuar në shishe është rritur nga një sipërmarrje e zakonshme në një industri shumë-milion dollarëshe. Popullariteti i ujit të ambalazhuar në shishe është bazuar gjerësisht në përpjekjen e suksesshme për të bindur konsumatorin se produkti që ai ble është më i sigurt për t'u pirë sesa uji që vjen në rubinetin e shtëpisë së tij. Një pikë tjetër kryesore për shitjen e ujit në shishe është dhe lehtësia për të pasur ujë me vete, praktikiteti që kanë shisjet për të mbajtur ujin me to, ndryshe nga uji që vjen në rubinet.

“Nga rubineti” është një dokumentar amerikan, i cili ngre një seri çështjesh të rëndësishme kundër konsumit dhe prodhimit në masë të ujit të ambalazhuar në shishe. Ai bën kërkime për disa probleme që lidhen me shëndetin dhe mjedisin, këto të lidhura ngushtë me maninë që kanë sot njerëzit për të konsumuar apo pirë ujë të ambalazhuar në shishe.

Çfarë uji pini?

Filmi fillon në shtetin Maine, në veri-lindje të Shteteve të Bashkuara, i njohur për cilësinë dhe pastërtinë e ujërave të burimeve të tij. Në vitin 1980, Korporata Nestle me seli në Zvicër (e cila në vitin 2008 fitoi 3.6 milion dollarë vetëm nga shitjet e ujit në shishe) përvetësoi një kompani lokale, të quajtur Poland Spring. Që prej atëhere kjo kompani është shndërruar në kompaninë e pestë më me emër në botë për ujin e ambalazhuar në shishe. Duke shfrytëzuar mbi 700 milion galonë ujë në vit, Nestle arriti të shiste produktin e saj përtej detit me një çmim disa herë më të madh sesa kostoja e nxjerrjes së tij (sipas disa vlerësimeve të bëra çmimi kalonte 1900 herë koston e ujit të rubinetit).

Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ujërat sipërfaqësore si liqenet, përrnjet dhe lumenjtë, janë pronë publike. Nga ana tjetër, burimet ujore nëntokësore janë pjesë e një grupi tjetër ligjesh dhe rregulloresh të përcaktuara sipas shteteve të ndryshme në Amerikë.

Sipas rrëfyesit të filmit, ligji në shtetin e Maine, i miratuar në fund të viteve 1800, me autoritetin suprem për këtë çështje, thotë: “Ai që ka pompat më të mëdha merr dhe sasinë më të madhe të ujit.” Kështu në Maine, me një popullsi prej 3000 banorësh, pompat e Nestle janë më të mëdhatë deri më tani.

Ajo çka po ndodh në komunitete të tilla si Fryeburg në Maine, sipas filmit, është thjesht shembulli i një fenomeni global, ku korporata të ndryshme po kërkojnë të kapin e të mbajnë nën kontroll burimet e ujit të pijshëm në mbarë botën, për përfitime vetjake. Me burime financiare të mëdha dhe me një arsenal ligjor të fuqishëm në dispozicion të korporatës, përpjekjet e izoluar të banorëve të zonës treguan se, edhe pse ata ekzistojnë, mund të bëjnë shumë pak për këtë çështje.

Thatësira dhe sasi të pakëta uji

Sot është realitet që burimet e ujërave nëntokësore janë duke u pakësuar, së pari nga rritja e popullsisë, nga varësia ndaj lëndës djegëse dhe nga ndryshimet klimatike. Nxjerrja e sasive të mëdha të ujit nga kompanitë më të mëdha të pijeve (si “tre kompanitë më të mëdha të Amerikës” - Nestle, Coca-Cola dhe Pepsi) e përkeqësojnë më tej problemin, veçanërisht në zonat ku janë ngritur stabilimentet e këtyre kompanive.

Dokumentari “Nga rubineti” na çon drejt Karolinës së Veriut dhe Georgias, dy shtete këto që përballojnë periudha të papara thatësire të tejjgatur.

Në vitin 2007-2008, Karolina e Veriut vuajti thatësirën më të madhe, të shënuar ndonjëherë në rajon. Dhe, pikërisht, në kulmin e kësaj thatësire,

Pepsi vazhdoi punën” për mbushjen e shisheve, duke marrë mbi 400,000 galon ujë në ditë”, thotë Eugene Brown, anëtar i Këshillit Bashkiak të qytetit të Durham.

E njëjta skenë shtjellohet në veri të shtetit të Georgias dhe në kryeqytetin e Atlantës, në mes të përjetimit të një thatësire të shkallës 4. Edhe pse qytetarëve iu ishte kërkuar të kursenin ujin e mos ta shpërdorënin atë, fabrika e mbushjes së shisheve Coca-Cola vazhdonte punën e saj të zakonshme me ambalazhimin e ujit. Sandra Brown, kryeredaktore e revistës Atlanta Magazine pohon se në 2007, fabrika Marietta përdori 118 milion galon ujë.

Presidenti dhe kryetari i Shoqatës Ndërkombëtare të Ambalazhimit të ujit, Joe Doss, duke iu referuar një studimi, pohoi se industria e fabrikimit të ujit është përgjegjëse për vetëm 0.02% të ujërave që nxirren nga burimet nëntokësore në të gjithë Shtetet e Bashkuara.

Përfaqësuesit e Kompanisë Nestle, të pyetur në parlament për ndikimin që ka kompania e tyre në mjedis, mohojnë kategorikisht çdo përgjegjësi të kompanisë për ndikim negativ në mjedis, duke bërë përgjegjës komunitetin, i cili ka qenë shumë aktiv në këtë çështje, por, gjithashtu, duke pranuar që nuk ka studime të pavarura që mbrojnë ose hedhin poshtë pohimet e tyre.

“Me kompani të tilla si Coca Cola, Pepsi, Nestle, të cilat janë kaq jetësore për ekonominë e zonës,” vazhdon rrëfimin filmi, “zyrtarët e qeverisë janë shpesh të detyruar të zgjedhin midis pasojave në mjedis apo humbjes së vendeve të punës për punëtorët që punojnë në këto kompani”.

Duke krijuar kërkesën konsumatore

Uji i ambalazhuar në shishe bëri bujë në tregjet amerikane për herë të parë në fund të viteve '70, kur

Perrier joshi banorët e qytetit me shisjet jeshile të ujit të gazuar, të cilat ishin të shtrenjta, por të ofruara si një mundësi zgjedhjeje e sofistikuar për koktejtet e drekës. Megjithatë, zbulimi i vërtetë erdhi në vitin 1989, me prezantimin e një emri shumë të njohur uji të ambalazhuar në shishe, i cili filloi të shitet në shishe plastike, të lehta në peshë e një përdorimshme, të përbëra nga materiali PET (polyethylene terephthalate). Duke mundësuar lehtësisht transportin e ujit dhe mundësinë për ta pasur kudo me vete, ky produkt i hedhur në treg nga një “nish” i vogël u shndërrua në një treg me shumicë.

Duke përdorur fjalë të tilla si “i brishtë”, i pastër, i freskët” përkrah pamjes që sillnin personazhe të famshëm të kohës për produktet, tregu i ujit të ambalazhuar në shishe ishte i lidhur ngushtë me së shumti me atë çka mund të quhet “ekzotike”. Një shembull i tillë ishte firma franceze e prodhimit të ujit “Evian”. Por, ky skenar ndryshoi dhe filloi të kishte një efekt të kundërt kur shisjet e ujit të kompanive kryesore në Shtetet e Bashkuara, si Coca Cola dhe Pepsi, hynë në tregun e ujërave të ambalazuara në shishe, me markat e tyre. Kështu, fabrikimi i ujit në shishe ishte një biznes shumë i madh, me një total shitjesh për vitin 2007 në 11.5 milion dollarë, sipas autores të Bottle mania, Elizabeth Royte.

Nga përbërja tek konteneri

Ndërkohë ajo çka lidhet me faktin se çdokush mund të mbajë një shishe me ujë me vete, mbetet për t’u diskutuar. Çelësi i shitjeve të ujit të ambalazhuar në shishe për industrinë që e prodhon mbetet promovimi që i bëhet argumentit se uji i ambalazhuar në shishe është më i pastër, domethënë më i sigurt për t’u pirë sesa uji që vjen në rubinetat e shtëpisë nga rrjeti i shpërndarjes nga bashkia.

Në mikroskop

Këshilli i Mbrojtjes së Burimeve Natyrore ka kryer analiza të pavarura për më shumë se 1.000 shishe uji dhe ka zbuluar një gamë ndotësish si arsenik dhe baktere, të lidhura me ujin që qëndron për një kohë të gjatë në shisjet plastike, çka konfirmon, sipas Adrianna Quintero, se “ju nuk e

dini atë që jeni duke pirë.”

Për dokumentarin “Nga rubineti”, regjizorët realizuan disa analiza shites për të testuar më tej këtë pretendim. Uji në shishe i marrë nga shtatë marka të ndryshme u dërgua në dy laboratorë të veçantë. Pas shqyrtimit të të dhënave, të cilat tregojnë praninë e toluenit, kloridevinilit, stirenit butadienit, benzenit dhe të tre llojeve të ndryshme ftalatesh, toksikologu Stephen King përshkruan rezultatet e testimit si “të tmerrshme”.

Megjithatë, problemi nuk përfundon me shisjet një përdorimshme të ujit. Nëse shikojmë enët pesë galonshe me ujë, të cilat përbëhen prej plastike me polikarbonat (si përbërës kryesor i tyre është Bisphenol-A [BPA]), ato janë të një natyre krejt të ndryshme, jashtëzakonisht të kundërshtueshme për efektet negative në shëndet. Frederik Vom Saal, profesor i Shkencave Biologjike në Universitetin e Misurit, i cili ka udhëhequr për një periudhë prej një dekade kërkimet mbi BPA-në në doza të ulta, paralajmëron se “mund të jetë një nga kimikatet më të fuqishëm toksikë të njohur për njeriun.”

BPA ka një përdorim të gjerë sot. Ai nuk është i pranishëm vetëm tek enët e mëdha të ujit të ambalazhuar, por përdoret gjerësisht dhe në prodhimin e shisheve sportive dhe të biberonëve. Por, ky përbërës kaq i diskutueshëm akoma i shpëton kontrollit të rreptë të Administratës Amerikane për Ushqimin dhe Drogat (FDA). Me qindra studime mbi BPA-në janë në dispozicion të FDA-së, por agjencia rregullatore ndalet vetëm në dy studime të kryera nga vetë industria kimike. Kur intervistuesi i filmit përballet me një zyrtar të FDA-së në lidhje me temën e BPA-së, zëdhënësi për shtyp i FDA-së, Mike Herndon, ndërhyr kur kamera është e fikur, duke thënë se “nëse do ta kisha ditur që do të flisnim për këtë, ndoshta nuk do ta kishim dhënë intervistën”.

Totalisht mbetje

Tema e fundit që adreson dokumentari “Nga rubineti” lidhet me çështjen e mbetjeve, shishja ku është ambalazhuar uji është një produkt mbetjeje e pastër. Dokumentari “Nga rubineti” argumenton se industria e ambalazhimit të ujit në shishe nuk ka

asnjë qëllim të nxisë apo të zgjerojë legjislacionin pro-riciklimit.

Filmi pretendon se norma mesatare e riciklimit në botë për enët e ujit është afërsisht 50%, ndërsa norma e riciklimit në Shtetet e Bashkuara është vetëm 20%, me rënien e vlerave vit pas viti. Çdo ditë në SHBA konsumohen rreth 80 milion shishe plastike një përdorimshme uji dhe rreth 30 milion konteinerë përfundojnë në venddepozitime.


Duke iu referuar fushatës së shisheve të ujit, 11 shtete të SHBA-së miratuan legjislacionin për depozitimin e këtyre konteinerëve (“faturë për shishe”), i cili fillimisht ishte i orientuar vetëm për pijet e lehta dhe produktet e birrës në kanaçe dhe enë alumini. Shumica e faturave kërkonin 5 cent (1/20 e dollarit) depozitë për një konteiner të vetëm, e paguar direkt nga konsumatori dhe e rimbursueshme në momentin e kthimit në vendin ku ishte marrë ose në pikat e grumbullimit. Norma e kthimit në shtetet ku u vendos kjo dispozitë u realizua afërsisht në 70%. Nga ana tjetër, shteti i Miçiganit, kur prezantoi ligjin “faturë për shishe” kërkoi si depozitë 10 cent nga konsumatorët, rezultat i të cilit ishte kthimi i lartë i enëve deri në 97%.

Argumentet kundër vijnë nga drejtuesit e industrive të shisheve, dukshëm egoistë: “Ne mendojmë se kjo është një taksë e panevojshme për konsumatorët amerikanë. Ajo që ne do të donim të shihnim është më shumë vende për grumbullim mbetjeje”, thotë Craig Stevens, zëvendëspresident i Shoqatës Amerikane të Pijeve. “Riciklimi në vendet e grumbullimit të mbetjeve është metodë e preferuar dhe mund të jetë shumë efektive, ne jemi duke u përpjekur të bëjmë gjithçka të mundur për të nxitur konsumatorët të riciklojnë”, pretendon Joe Doss.

Meqënëse uji i ambalazhuar në shishe nuk ekzistonte kur është miratuar legjislacioni “faturë për shishe”, ka patur presion për të zgjeruar legjislacionin ekzistues, duke përfshirë dhe konteinerët e ujit të ambalazhuar në shishe, por kjo ka ndodhur vetëm në 6 shtete nga 11 që kanë legjislacionin e “faturës për shishe”. Ndërkohë që grumbullimi i mbetjeve është i praktikueshëm vetëm te 50% e amerikanëve.

AKTE LIGJORE MJEDISORE NË SHQIPËRI

LEGJISLACIONI I KONSOLIDUAR
(korrik 1991 - shtator 2012)



në version elektronik...

Kërkoni kopjen tuaj ose vizitoni <http://albania.rec.org>



QENDRA RAJONALE E MJEDISIT
Shqipëri